



*Leading the way  
in Customer Interaction  
& Process Management.*

A large, diagonal photograph of hands stacking wooden blocks, overlaid with a blue-to-red gradient bar. The image is partially obscured by a large, diagonal, semi-transparent graphic element that transitions from blue at the bottom to red at the top.

## Politika Antikorrupsion Grupi Comdata

Miruar nga Bordi i Drejtorëve të Comdata Spa  
05 Mars 2021

# Indeksi i Përmbajtjes

<b>Hyrje</b>	<b>2</b>
1. Qëllimi	3
2. Deklarimi i Policy*	5
3. Fusha e zbatimit	8
4. Miratimi dhe zbatimi nga ana e Shoqërive të Grupit	10
5. Përkufizime	12
6. Rolet dhe përgjegjësitë	16
7. Parimet e përgjithshme	18
8. Parimet e sjelljes në fushat kryesore sensitive	21
9. Trajnimi i personelit	30
10. Raportimi i sjelljeve të papërshtatshme	32
11. Masat sanksionuese	34
12. Monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm	36
13. Flukset e informacionit	38

# Hyrje

Grupi Comdata, i vetëdijshëm për efektet negative të praktikave korruptive në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në zonat ku operon, është angazhuar për të parandaluar dhe luftuar shfaqjen e paligjshmërisë në kryerjen e aktiviteteve të tij.

Parandalimi i praktikave korruptive përfaqëson për Grupin Comdata, përveç një detyrimi ligjor, një nga parimet mbi të cilat ndërtohen veprimet e Grupit.

Si një zbatim konkret i angazhimit të tij në këtë fushë, Grupi Comdata ka miratuar Kodin e Etikës, i cili përcakton vlerat nga të cilat Grupi frymëzohet për të arritur objektivat e tij dhe parimet përkatëse në kryerjen e veprimtarive, në plotësim të instrumenteve të Drejtimit dhe Pajtueshmërisë të miratuar nga shoqëritë e veçanta të Grupit.

Ky dokument është i përfshirë në kuadrin më të gjerë të "Programit të Pajtueshmërisë së Comdata-s" ("CCP") i cili u lançua nga Grupi Comdata për të harmonizuar sistemet e kontrollit të brendshëm të krijuar pranë subjekteve të ndryshëm juridikë të Comdata-s dhe për të promovuar sjelljen etike nga Personeli Comdata. CCP përkthehet në zhvillimin dhe përditësimin e procedurave të brendshme që synojnë parandalimin e shkeljes së ligjeve, rregulloreve, kodeve të sjelljes, politikave të Grupit, si dhe Kodit të Etikës së Grupit, pra, indirekt, parandalimin e sanksioneve, humbjeve financiare ose dëmtimin e reputacionit.

1/

Qëllimi



Me paraqitjen e kësaj Politike, në konfirmim të mëtejshëm të angazhimit të tij kundër sjelljeve të paligjshme, Grupi Comdata synon të përmbledhë dhe të integrojë në një kuadër organik rregullat e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit tashmë në fuqi në Grup, me qëllim rritjen e mëtejshme të vetëdijes së Marrësve për rregullat dhe sjelljet që duhet të respektohen.

Kjo Politikë është krijuar për t'u zbatuar nga të gjitha shoqëritë e Grupit Comdata, në vende të ndryshme në të cilat veprojnë dhe ofron për secilën kompani një kuadër të dobishëm referimi për identifikimin, rishikimin dhe arritjen e objektivave në lidhje me antikorrupsionin, të përcaktuara në përputhje me të këtë Politikë.

2/

*Deklarimi  
i Policy*



Në përputhje me legjislacionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në zbatim të dispozitave të Kodit të Etikës, Grupi Comdata nuk toleron asnjë formë korrupsioni, të realizuar qoftë direkt ose indirekt, si aktiv (ose i realizuar ndaj palëve të treta) ashtu dhe pasiv (ose që pësohet nga palë të treta).

Veçanërisht, në lidhje me biznesin aktual ose potencial të Grupit dhe në çdo rast për secilën fushë me interes të veprimtarisë së vetë Grupit, Përfituesit e Politikës janë të ndaluar:

/ t'i ofrojnë, premtojnë, japin, paguajnë - drejtpërdrejt ose përmes një personi tjetër - përfitime të padrejta, avantazhe ekonomike të çdo vlere ose shërbime të tjera, edhe joekonomike, një pale të tretë (në rolin e tij si zyrtar publik ose punonjës i shërbimeve publike ose i palës tjetër private) si një nxitje ose shpërblim për të vepruar në përputhje ose në kundërshtim me detyrën e tij ose për të mos kryer veprime në lidhje me detyrat e veta, pavarësisht nga vendi ku është bërë ose ofruar dhurimi dhe vendi ku palët e treta ose Marrësi operojnë;

/ të kërkojnë, marrin, pranojnë - drejtpërdrejt ose përmes një personi tjetër - përfitime të padrejta, avantazhe ekonomike të çdo vlere ose shërbime të tjera, edhe joekonomike, nga një palë e tretë (në rolin e tij si zyrtar publik ose punonjës i shërbimeve publike ose i palës tjetër private) si një nxitje ose shpërblim për të vepruar në përputhje ose në kundërshtim me detyrën e tij ose për të mos kryer veprime në lidhje me detyrat e veta, pavarësisht nga vendi ku është bërë ose ofruar dhurimi dhe vendi ku palët e treta ose Marrësi operojnë.

Ndalohen dhe veprimet e përmendura në paragrafin 8 të mëposhtëm.

Shkelja e rregullave të përmendura në këtë politikë, përveçse përbën shkelje të Kodit të Etikës, mund ta ekspozojë Grupin Comdata dhe Shoqëritë e Kontrolluara të tij ndaj rrezikut të sanksioneve, si dhe ndaj dëmtimit serioz të reputacionit.

Në zbatim të parimit të **“tolerancës zero”**, Grupi Comdata nuk pranon përjashtime nga dispozitat dhe ndalimet e përcaktuara në këtë politikë. Bindja për të vepruar për të mirën e Grupit nuk mund të justifikojë në asnjë mënyrë

adoptimin e sjelljeve në kundërshtim me parimet e lartpërmendura. Rastet e shkeljes, edhe nëse janë vetëm të dyshuara, të Politikës ose Dispozitave Antikorrupsion duhet të raportohen menjëherë siç parashikohet në paragrafin 10 të mëposhtëm.

Grupi Comdata garanton që asnjë punonjës nuk do të sanksionohet, pushohet nga puna, zhvishet nga detyra, pezullohet, transferohet ose

diskriminohet në ndonjë mënyrë (i) për shkak të refuzimit të përfshirjes në sjellje të paligjshme, edhe nëse nga ky refuzim kanë ardhur pasoja të dëmshme për biznesin e Grupit, as (ii) për raportimin në mirëbesim për shkelje të Dispozitave Antikorrupsion ose të Politikës.



3/

*Fusha  
e zbatimit*




Kjo politikë miratohet nga Bordi Drejtues i Comdata S.p.A. dhe miratimi i saj është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë e kontrolluara prej tij (direkt ose indirekt) të cilat e pranojnë me aderimin zyrtar nga organi i tyre administrativ.

Respektimi i Dispozitave Antikorrupsion dhe i Politikës është e detyrueshme për të gjithë Marrësit.

Në rast se disa norma të zbatueshme të Dispozitave Lokale Antikorrupsion janë më të rrepta sesa ato që mund të merren nga Politika, këto norma në çdo rast duhet të respektohen, dhe në çdo rast shkelja e tyre do të përbëjë gjithashtu edhe një shkelje të Politikës.

4/

# Miratimi dhe zbatimi nga ana e Shoqërive të Grupit



Çdo kompani e Grupit miraton këtë politikë pa përjashtime që nuk justifikohen nga dispozitat referuese rregullator lokale në fuqi.

Nëse, për shkak të specifikave të kontekstit të referencës, një Shoqëri e Kontrolluar e huaj duhet të miratojë kodin e vet antikorrupsion, kodi i përmendur duhet në çdo rast të jetë në përputhje me Politikën, duke pasqyruar, si bazë e domosdoshme, përmbajtjen e saj.

Çdo Shoqëri e Kontrolluar miraton çdo mjet të mëtejshëm parandalimi dhe kontrolli për t'u përballur me rreziqet e saj specifike dhe për të rregulluar proceset që karakterizojnë veprimtarinë e saj, duke pasur parasysh veçanërisht kontekstin ligjor dhe operacional referues.



5/

*Përkufizime*



Për qëllim të kësaj Politike, termat e listuara marrin kuptimin e specifikuar më poshtë:

Termi	Përshkrimi
Autoriteti ose Administrata Publike	I bëhet referim sa për ilustrim dhe jo në mënyrë shteruese, Autoriteteve Gjyqësore, Institucioneve dhe Administratës Publike vendase, ndërkombëtare dhe komunitare, rajonale e lokale, Garantit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe autoriteteve analoge kombëtare dhe Autoritetit të mbikëqyrjes, kombëtare, ndërkombëtare dhe komunitare, rajonale e lokale, ose subjekteve privatë të barazvlefshëm me ta pasi kanë të drejtat e ruajtjes, si dhe funksionarëve përkatës dhe organeve të brendshëm, ndër të cilër Zyrtarët Publikë, të ngarkuarit me Shërbimet Publike, si dhe Personat e Ekspozuar Politikisht.
Kodi Etik	Kodi Etik i Grupit Comdata.
Comdata	Comdata S.p.A.
Komiteti i Compliance ose Comdata Compliance Committee (CCC)	Komiteti i brendshëm i ngritur me vendim të Bordit Drejtues të Comdata SpA, përgjegjës për zbatimin e Compliance Program të Grupit Comdata, është një organ me rol koordinues dhe drejtues në miratimin e sistemeve të përshtatshëm të kontrollit dhe parandalimit të rreziqeve të shoqërisë dhe të Compliance.
Comdata Compliance Programme ose CCP	Programi i vetëdisiplinimit i Grupit Comdata që synon promovimin e sjelljes etike dhe zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit, rregulloreve dhe politikave të grupit. Compliance Program i Comdata-s synon të sigurojë respektimin e kërkesat ligjore të zbatueshme të shtetit dhe monitorimin adekuat të rreziqeve të biznesit.
Korrupsioni	Sjellja e kujtdo që, duke kryer veprimtari drejtpërdrejt ose indirekt për llogari ose në interes të Shoqërive të Grupit, ofron, premtan, merr ose u jep përfitime dhe / ose kompensime të padrejta palëve të treta, drejtpërdrejt ose indirekt (dhe për këtë arsye edhe përmes një personi të ndërfutur), për një avantazh personal, ose të shoqërive

Termi	Përshkrimi
	<p>të Grupit ose palëve të treta. Për qëllimet e Politikës (Policy), nuk është i rëndësishëm dallimi midis “korrupsionit ndaj një zyrtari publik ose një zyrtari të shërbimit publik” dhe “korrupsionit ndaj një privati”. Gjithmonë për qëllimet e kësaj Politike (Policy), si referenca të njohura përgjithësisht quhen edhe përkufizimet e korrupsionit të miratuara përkatësisht nga Transparency International (“abuzimi i pushtetit të besuar për përfitime private”) dhe nga Banka Botërore (“offering, giving, receiving or soliciting, directly or indirectly, anything of value to influence improperly the actions of another party”).</p>
Korrupsioni aktiv	<p>sjellja korruptive e kryer nga një person që i përket organizatës Comdata (ose një palë e tretë që vepron në emër, në emër për llogari ose në interes të organizatës Comdata) me qëllim dëmtimin e kryerjes së rregullt dhe konforme të aktiviteteve të palës tjetër dhe që synon realizimin e një interesi ose avantazhi për shoqërinë së cilës i përket.</p>
Korrupsioni pasiv	<p>sjellja korruptive e kryer nga një person i jashtëm i organizatës Comdata me qëllim dëmtimin e kryerjes së rregullt dhe konforme të aktiviteteve të organizatës Comdata dhe që synon realizimin e një dëmi për këtë të fundit.</p>
Marrësit	<p>Personeli i Grupit në botë dhe të gjithë ata që operojnë në emër dhe/ose për llogari dhe/ose interes të Grupit Comdata ose që me këtë mbajnë marrëdhënie profesionale ose biznesi.</p>
Group Internal Audit	<p>Drejttoria Internal Audit e Grupit.</p>
Grupi Comdata ose Grupi (ose edhe Shoqëritë e Grupit)	<p>Comdata dhe Shoqëritë e Kontrolluara.</p>
I ngarkuar nga Shërbimi Publik	<p>Për efekt të ligjit penal, është i ngarkuar i një shërbimi publik, ai që edhe pse nuk është tamam një Nëpunës Publik me funksionet e këtij statusi (certifikuese, autorizuese, vendimmarrëse), të çdo lloji, ofron një shërbim publik.</p>

Termi	Përshkrimi
Modele ose Sisteme compliance	Modele apo sisteme organizative që synojnë përkufizimin dhe implementimin e rregullave të drejtimit të shoqërisë dhe të respektimit të ligjeve dhe rregulloreve <sup>1</sup> .
Normativa Antikorrupsion	<p>Dispozitat kombëtare të aplikueshme në Vende të veçanta ku Grupi Comdata vepron, best practices (praktikat më të mira) dhe udhëzimet e përgatitura nga organizata private ndërkombëtare (ICC – Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Transparency International, PACI – Partnering Against Corruption Initiative dhe Global Compact i Kombeve të Bashkuara, UNI ISO 37001), si dhe Konventat në vijim të së drejtës ndërkombëtare, të listuara për ilustrim jo shterues:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>/// Konventa e OSBE për luftën ndaj korrupsionit të nëpunësve publikë të huaj në operacionet ekonomike ndërkombëtare (1997);</li> <li>/// Konventa Penale mbi korrupsionin e Këshillit të Evropës (1999);</li> <li>/// Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (2004).</li> </ul>
Organet e Drejtimit dhe Kontrollit të Comdata S.p.A.	Është organi drejtues i Comdata S.p.A. Bordi Drejtues; janë Organe Kontrollit të Comdata S.p.A. Bordi i Auditëve dhe Organizmi i Mbikëqyrjes.
Personeli i Grupit Comdata	Punonjësit e Comdata-s dhe i Shoqërive të Grupit (punonjësit, konsulentët dhe bashkëpunëtorët)
Persona të Ekspozuar Politikisht ose PEP	personat fizike që mbajnë ose kanë pushuar së mbajturi prej më pak se një viti, detyra të rëndësishme publike, si dhe familjarët e tyre dhe ata që dihet se me subjektet e mësipërm mbajnë lidhje të ngushta.
Policy	Policy Antikorrupsion e miratuar nga Comdata dhe nga Shoqëritë e Kontrolluara në bazë të parashikimeve sipas paragrafëve 3 dhe 4.
Nëpunësi Publik	Personi që ushtron një funksion publik legjislativ, administrativ ose gjyqësor, pavarësisht nga fakti se funksioni rrjedh nga emërimi, zgjedhja apo trashëgimia.
Shoqëri të Kontrolluara	Shoqëritë, e kontrolluara direkt ose indirekt nga Comdata.

<sup>1</sup> Për ilustrim, përmendim për Italinë, Dekretin legjislativ nr. 231/2001, Kodi i Vetëdisiplinimit i Bursës Italiane; për Spanjën la Ley Orgànica nr. 5/2010; për Francën, la Loi n. 2016-1691 "Loi Sapin II" si dhe referenca të tjera ndërkombëtare për rregullimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të luftës ndaj korrupsionit (për shembull: Sarbanes-Oxley e Foreign Corrupt Practices Act – FCPA në SHBA).



6/

*Role  
e përgjegjësi*



Në nivel qendror, në kuadrin e detyrave që mbulon, Drejtoria Internal Audit e Grupit garanton mbizotërimin e përputhshmërisë për parandalimin e korrupsionit.

Veçanërisht, Drejtoria Internal Audit e Grupit siguron zbatimin e kësaj Politike dhe verifikimin e plotësisë të kërkesave të përgjithshme të sistemit të menaxhimit të parandalimit të korrupsionit si dhe monitorimin konstant të rrezikut të korrupsionit, sipas mënyrave të mëposhtme:

- i. direkt, nëpërmjet planifikimit të vet dhe kryerjes së veprimeve të verifikimit, monitorimit të funksionimit efektiv dhe eficient të sistemit të kontrollit të brendshëm për parandalimin e fenomenit të korrupsionit në shoqëritë e vendosura nën drejtimin e tyre të drejtpërdrejtë;
- ii. indirekt, nëpërmjet funksioneve të posaçme lokale të ngarkuara me monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm pranë shoqërive të kontrolluara, planifikimi dhe kryerja e veprimeve të verifikimit, si dhe monitorimi i funksionimit

efektiv dhe eficient të sistemit të kontrollit të brendshëm për parandalimin e fenomenit të korrupsionit në shoqëritë e vendosura nën drejtimin e tyre të drejtpërdrejtë.

Komiteti i Compliance i Comdata S.p.A. përgjigjet për vlerësimin e planifikimit të veprimeve eventuale rregulluese, korigjuese dhe përmirësuese, që rezultojnë të nevojshme për të tejkaluar mospërputhshmëritë e evidentuara nga Drejtoria Internal Audit e Grupit si rezultat i veprimeve të verifikimit.

Vendimet e marra nga Komiteti i Compliance i Comdata S.p.A. u përcillen zyrtarisht funksioneve kompetente qendrore (Comdata S.p.A.) dhe/ose periferike (shoqëri të kontrolluara) për ndërmarrjen e veprimeve rregulluese, në kohën dhe mënyrat që do të përcaktohen nga Komiteti.

71

*Parime  
të përgjithshme*



Për respektimin e Policy, Grupi miraton dhe respekton kriteret e përgjithshme në vijim:

a) ***Ndarja e përgjegjësi:***

kur është e mundur personi përgjegjës për një veprimtari operacionale duhet të jetë gjithmonë një person tjetër i ndryshëm nga ai që kontrollon veprimtarinë e lartpërmendur (dhe/ose nga ai që e autorizon atë kur parashikohet), duke qenë e nevojshme për këtë që veprimtaritë operacionale dhe funksionet e kontrollit të jenë të ndara në mënyrën e duhur;

b) ***kompetencat e firmës:***

kompetencat e firmës duhet të zyrtarizohen në mënyrën e duhur dhe të përcaktohen qartë, ato duhet të jepen në lidhje të ngushtë me kërkesat e shpenzimit të firmës së shoqërisë, të përgjegjësi specifike organizative dhe menaxheriale të përfaqësuesit; ushtrimi i tyre konkret duhet të respektojë si kufijtë e përcaktuar nga vlera ose nga lënda, ashtu dhe direktivat dhe procedurat e ndërmarrjes, si dhe dispozitat e zbatueshme;

c) ***paanshmëria dhe mungesa e konfliktit të interesit:***

Përfituesit e Politikës duhet të veprojnë me profesionalizëm, transparencë, paanshmëri dhe në përputhje me normat antikorrupsion dhe duhet të raportojnë menjëherë çdo situatë nga e cila mund të lindë një konflikt interesi;

d) ***gjurmueshmëria dhe arkivimi:***

e gjithë veprimtaria e zhvilluar dhe kontrollet përkatëse të kryera duhet të gjurmohen dhe të verifikohen a posteriori; dokumentacioni i paraqitur duhet të arkivohet në mënyrë të rregullt dhe të jetë lehtësisht i disponueshëm;

e) ***njihni partnerin tuaj:***

çdo funksion i ndërmarrjes përgjegjës për një proces të caktuar (i ashtuquajtur "process owner") duhet të zbatohet, brenda fushës së kompetencës së tij, metoda të përshtatshme (sipas kriterëve të arsyeshmërisë dhe proporcionalitetit në lidhje me llojin e marrëdhënies që do të krijohet) për (i) verifikimin e besueshmërisë, profilin e reputacionit dhe përshtatshmërinë e palëve të treta me të cilët Grupi Comdata

po konsideron krijimin e një marrëdhënieje profesionale ose biznesi, (ii) parashikimin e klauzolave specifike kontraktore që angazhojnë palët e treta për respektimin e parimeve të përfshira në Kodin e Etikës, në Policy dhe në procedurat dhe protokollet e përcaktuara për respektimin e Dispozitave Antikorrupsion, dhe (iii) për të kontrolluar efektivitetin e shërbimeve të ofruara nga palët e treta në zbatim të kontratave të lidhura me Shoqëritë e Grupit, si dhe për të konstatuar detyrimin dhe saktësinë e tarifave që duhen paguar.

Përsëri si një kriter i përgjithshëm, për qëllime të zbatimit të Policy, duhet të konsiderohen të ndaluara sa më poshtë (si sjelljet e ndalimeve të përmendura në këtë Policy, dhe veçanërisht në **paragrafin 8**.

▮ çdo sjellje tjetër, edhe nëse nuk ndalohet shprehimisht nga Policy, që ka të njëjtin qëllim me një ose më shumë sjellje të referuara në ndalimet e përmendura në Policy;

2. çdo mënyrë për të anashkaluar ose përjashtuar ndalimet e përmendura në Policy

▮ (dhe për këtë arsye, thjesht me një shembull jo shterues:  
a) një sjellje specifike e përmendur në Policy është e ndaluar edhe nëse autori përdor fonde ose mjete personale apo të vëna në dispozicion nga një palë e tretë jashtë Grupit; b) një donacion parash ose përfitime të tjera të përmendura në Policy është i ndaluar edhe nëse përfituesi nuk është personi i përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e kompanisë – Nëpunës Publik, furnitor, ortak, etj. - por një anëtar i familjes, i emëruar, ndërmjetës, kreditor, debitor, etj; c) ndalimi i dhënies ose marrjes së dhuratave që nuk janë me vlerë modeste ndalon gjithashtu të njëjtin marrës nga dhënia/ pranimi - për/nga e njëjti subjekt - një numër të konsiderueshëm dhuratash, secila me vlerë modeste, në një periudhë kohe të konsiderueshme të vlerësueshme për qëllimet e Policy. Secila shoqëri e Grupit do të shpërndajë Politikën ndërmjet partnerëve të saj tregtarë dhe financiarë, profesionistëve, konsulentëve, promovuesve komercialë, bashkëpunëtorëve në cilësi të ndryshme dhe furnitorëve, duke e publikuar gjithashtu në faqen e internetit të Shoqërisë.

8/

*Parimet  
e sjelljes  
në fushat  
kryesore  
sensitive*





Në lidhje me llojet e aktiviteteve të Grupit Comdata, përcaktohen si më të ndjeshme ndaj rrezikut të korrupsionit fushat e mëposhtme:

- i. Marrëdhëniet me Administratën Publike (të kuptuara në të gjitha artikujt e mundshme)
- ii. Dhuratat, shpenzimet e pritjes dhe përfaqësimi
- iii. Pagesat për lehtësimet
- iv. Caktimi i detyrave të konsulencës, të specializuara dhe profesionale
- v. Caktimi i punës së furnizimit me të mira e shërbime
- vi. Marrja e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera dhe Joint Ventures (M&A)
- vii. Selektimi, punësimi dhe menaxhimi i personelit
- viii. Nismat non profit dhe sponsorizimet
- ix. Aktiviteti i zhvillimit tregtar
- x. Regjistrimet kontabël

Për sa i përket biznesit aktual ose potencial të Grupit e sidoqoftë për çdo fushë aktiviteti me interes të

vetë Grupit, Marrësit duhet t'i përmbahen parashikimeve të Kodit Etik, në procedurat dhe protokollet e përcaktuara për respektimin e Normave Antikorrupsion, si dhe parimeve të mëposhtme të sjelljes.

- i. Marrëdhëniet me Administratën Publike (të kuptuara në të gjitha artikujt e mundshme)

Marrëdhëniet që Grupi ka me përfaqësuesit e Administratës Publike (A.P.) të kuptuara në të gjitha artikujt e mundshme, duhet të frymëzohen nga respektimi i rreptë i Rregullave Antikorrupsion dhe nuk mund të kompromentojnë në asnjë mënyrë integritetin dhe reputacionin e Grupit.

Ndërmarrja e angazhimeve dhe menaxhimi i marrëdhënieve të çdo lloji me përfaqësuesit e Administratës Publike dhe / ose entet me rëndësi publike janë të rezervuara vetëm për figurat dhe funksionet e ndërmarrjeve që janë përgjegjëse dhe të autorizuara për këtë. Në marrëdhënie të tilla, Grupi nuk duhet të kërkojë të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme vendimet ose veprimet e institucionit

në fjalë, as drejtpërdrejt, as duke shfrytëzuar ndërmjetësimin e palëve të treta (reale ose të shpikura).

Duke iu referuar veçanërisht marrëdhënieve me Organet Mbikëqyrëse dhe të Kontrollit, Grupi merr përsipër të respektojë në mënyrë rigoroze rregullat e përcaktuara prej tyre për respektimin e dispozitave në fushat e kompetencës së vet. Punonjësit e Grupit do të përmbushin çdo kërkesë të këtyre organeve në funksionet e tyre të inspektimit, duke bashkëpunuar në veprimtaritë përkatëse.

ii. Dhuratat, shpenzimet e pritjes dhe përfaqësimi

Dhuratat dhe shpenzimet e tjera të përfaqësimit lejohen si një praktikë e zakonshme e kortezisë profesionale dhe komerciale, pa iu shmangur ndalimit të ofrimit ose pranimit të shumave të parave.

Për këtë qëllim, dhuratat dhe çdo përfitim ose dobi tjetër që Marrësit u ofrojnë (ose pranojnë prej tyre) subjekteve publike ose private, në lidhje me rrethanat, duhet: a) të rezultojnë të përshtatshme, të arsyeshme

dhe në mirëbesim i) të rezultojnë të tilla që (i) të mos kompromentojnë integritetin dhe reputacionin e asnjë pale në marrëdhënie, as (ii) t'i ngjallin përfituesit ose një pale të tretë të paanshme përshtypjen se ato kanë për qëllim marrjen, mbajtjen ose shpërblimin e avantazheve të parregullta ose ushtrimin e një ndikimi i paligjshëm ose të papërshtatshëm në veprimtarinë ose vendimet e përfituesit, (c) të regjistrohen dhe në çdo rast të mos ofrohen ose pranohen në një mënyrë të fshehtë, (d) të jenë në përputhje me Nrmat Antikorrupsion, procedurat dhe protokollet e ndërmarrjes.

Pa cënuar respektimin e kriterëve të sipërpërmendura, Përfituesit mund të ofrojnë ose pranojnë dhurata, ose ndonjë përfitim ose shërbim tjetër, nëse ato janë me vlerë modeste.

iii. Pagesa e lehtësive

Grupi shprehimisht ndalon, sinë Itali dhe jashtë saj, të gjitha të ashtuquajturat pagesa lehtësuese, ose çdo lloj pagese ose përfitimi tjetër të bërë direkt ose indirekt për Nëpunësit Publikë ose Zyrtarët e Shërbimit Publik, apo individë privatë,



qofshin ata persona fizikë ose subjekte ekonomike, italiane ose të huaj, në mënyrë që të shpejtojnë, lehtësojnë ose thjesht të sigurojnë kryerjen e një aktiviteti rutinë ose një aktiviteti që është në çdo rast ligjor dhe i ligjshëm si pjesë e detyrave të këtyre subjekteve.

- iv. Marrëdhëniet me organizatat politike e sindikale Grupi nuk ofron kontribute të asnjë lloji, direkt ose indirekt për partitë politike, lëvizjet, komitetet dhe organizatat politike e sindikale, as për përfaqësuesit apo kandidatët e tyre, si në Itali, ashtu dhe jashtë shtetit, duke mos cënuar sa është përcaktuar e lejuar nga normativa e zbatueshme.
- v. Caktimi i detyrave të konsulencës, të specializuara dhe profesionale Procesi i zgjedhjes së profesionistit që do të emërohet duhet të jetë në përputhje me kriteret e profesionalizmit, transparencës, paanësisë, ekonomisë dhe efikasitetit. Procedurat e ndërmarrjes zbatojnë kriteret e lartpërmendura, duke rregulluar me detaje proceset përkatëse.

Në veçanti, sigurohen metodat themelore të mëposhtme:

- / kur, në lidhje me objektin e detyrës, justifikohet mbizotërimi i intuitu personae si kriter i zgjedhjes, duke arsyetuar paraprakisht nevojën për caktimin e detyrës, procedohet me punësimin e një profesionisti të caktuar; funksioni i ndërmarrjes “process owner” siguron përmes hetimit adekuat që profesionisti i zgjedhur nga funksioni i lartpërmendur të ketë kërkesat e integritetit, standing, reputacionit, besueshmërisë, profilin organizativ, aftësimet, kualifikimet tekniko-profesionale dhe kompetencave të nevojshme për kryerjen e detyrës;
- / në raste të tjera, gjithmonë pasi të ketë dhënë arsye për nevojën e caktimit dhe duke ndjekur kriteret e rotacionit për aq sa është e mundur, procedohet me zgjedhjen e profesionistit përmes një krahasimi konkurrues midis disa kandidatëve me karakteristika të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë që do të besohet; funksionet e ndërmarrjeve të ngarkuara

sigurojnë që profesionisti që do të punësohet të ketë kushtet e integritetit, standing, reputacionit, besueshmërisë, profilit organizativ, aftësimeve, kualifikimeve tekniko-profesionale dhe kompetencave të nevojshme për kryerjen e detyrës;

/ në të gjitha rastet, funksionet kompetente të ndërmarrjes duhet të verifikojnë që nuk ka papajtueshmëri ose konflikt interesi për profesionistin, dhe gjithashtu duhet të verifikojnë që vendi në të cilin banon profesionisti (ose ku ka selinë subjekti) nuk është përfshirë në listën e Vendeve me regjim fiscal të privilegjuar, nëse ky vend është i ndryshëm nga ai në të cilin duhet të kryhen shërbimet;

/ kontratat dhe/ose marrëveshjet e lidhura me profesionistët e zgjedhur duhet të paraqesin me qartësi shteruese dhe detaje të përshtatshme shërbimet e kërkuara dhe kriteret e maturimit të pagesave të rëna dakord.

Procesi i zgjedhjes së profesionistëve, kontratat dhe marrëveshjet e lidhura me

ta dhe shërbimet e kryera duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara.

vi. Caktimi i punëve dhe furnizimi i të mirave dhe shërbimeve

Praktika e përzgjedhjes së furnizuesve nga Grupi duhet të kryhet në përputhje me kriteret e transparencës, gjurmueshmërisë, publicitetit, konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë dhe rotacionit në bazë të kriterëve objektive të lidhura me konkurrencën dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të kërkuara. Procedurat e ndërmarrjes zbatojnë kriteret e mësipërme, duke rregulluar proceset përkatëse në detaje.

Në veçanti, sigurohen detyrimet themelore të mëposhtme:

/ të respektojë me përpikëri ligjislacionin në fuqi në Vendet ku vepron Grupi;

/ të miratojë kritere objektive dhe transparente vlerësimi në përzgjedhjen e ndërmarrjeve furnizuese;

/ të respektojë dhe të ndjekë, në marrëdhëniet e furnizimit, dispozitat ligjore në fuqi dhe kushtet e parashikuara në kontratë;

/ të frymëzohet nga parimet e korrektësisë dhe besimit të mirë në korrespondencë dhe dialog me furnitorët, në përputhje me praktikat më rigoroze tregtare.

Nevoja për të ndjekur avantazhin maksimal konkurrues për Grupin duhet në çdo rast të sigurojë miratimin, nga furnizuesit e tij, të zgjidhjeve operacionale në përputhje me legjislacionin aktual dhe, më në përgjithësi, me parimet në fushën e mbrojtjes së personit, të shëndetit dhe sigurisë së punëtorët dhe mjedisit.

#### vii. Marrjet e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera dhe Joint Ventures (M&A)

Iniciativat e M&A të Grupit duhet të sigurojnë (nën përgjegjësinë e funksionit të kompanisë "process owner", me mbështetjen e funksionit juridik kompetent dhe strukturave të tjera të interesuara) verifikimin e duhur

dhe të arsyeshëm të pales tjetër në lidhje sidomos me identitetin e tyre, profilin e reputacionit dhe besueshmërinë, me ekzistencën e mundshme të procedimeve ose dënimeve për vepra penale korrupsioni (ose për krime të tjera të tilla që ndikojnë në moralin profesional) kundër vetë palës tjetër ose subjekteve të saj të rëndësishëm (p.sh.: aksionarët, drejtorët, menaxherët e lartë, etj.). Me palë tjetër nënkuptojmë si pjesën e veprimeve të M&A (për shembull, personi që shet një kuotë të pjesëmarrjes në një firmë tek një shoqëri e Grupit), ashtu edhe objektivin e transaksionit të lartpërmendur (për shembull, firma së cilës një shoqëri e Grupit I blen një kuotë pjesëmarrjeje). Kontrollat adekuate që duhet të kryhen për objektivin duhet të kenë të bëjnë gjithashtu me identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të ashtuquajtur "të trashëgueshëm", lidhur me çdo akt korrupsioni të kryer në të kaluarën. Në vlerësimet paraprake, Grupi gjithashtu konsideron miratimin e mundshëm të politikave dhe procedurave antikorrupsion brenda organizatës së palës tjetër.

Nëse objektivi i iniciativës M&A bëhet pjesë e Grupit, siç parashikohet në paragrafin 4 më lart, ky objektivi do të miratojë këtë Policy (ose kodin e vet në çdo rast në përputhje me përmbajtjen e Policy, kur miratimi i një kodi do të ishte i nevojshëm për specifikat e kontekstit të referencës).

#### viii. Përzgjedhja, punësimi dhe menaxhimi i personelit

Përzgjedhja dhe punësimi i personelit të Grupit Comdata udhëhiqen nga parimet e korrektësisë dhe paanshmërisë. Grupi Comdata punëson burime me profile që përputhen efektivisht me kërkesat e ndërmarrjes, duke bërë (ashti si për menaxhimin e burimeve aktuale të organikës) zgjedhje të bazuara vetëm mbi kriteret e profesionalizmit dhe kompetencës dhe duke mbajtur larg çdo formë favorizimi. Gjithashtu, në menaxhimin e personelit të punësuar, Grupi Comdata siguron miratimin dhe zbatimin e procedurave të përshtatshme të brendshme për përcaktimin e kriterëve objektive dhe të verifikueshme mbi të cilat bazohet vlerësimi periodik

i punonjësve, si dhe njohjen e shpërblimeve, çmimeve dhe përfitimeve me karakter ekonomik dhe/ose përcaktimin e procesit të karrierës. Për më tepër, gjatë procesit të përzgjedhjes, kandidatët duhet të deklarojnë tashmë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, ekzistencën e mundshme të situatave dhe rrethanave që Grupi i konsideron të rëndësishme me qëllim vlerësimin mbi vazhdimin e mundshëm të procesit të përzgjedhjes (p.sh. marrëdhëniet familjare me persona të administratës publike, dënimet penale, papajtueshmëritë, etj.). Departamenti kompetent i Burimeve Njerëzore i secilës shoqëri të Grupit është përgjegjës për të siguruar që proceset e përzgjedhjes, rekrutimit dhe menaxhimit për të cilat është përgjegjës, të jenë në përputhje me parimet dhe kriteret e lartpërmendura pa përjashtim, madje edhe në rastin e aplikimeve të paraqitura nga Marrësit.

ix. Nismat no profit dhe sponsorizimet

Nismat no profit dhe sponsorizimet hyjnë në diskrecionin e ndërmarrjes sipas praktikave të zakonshme të biznesit.

Aktivitetet e lartpërmendura kryhen nga shoqëritë e Grupit në përputhje me procedurat dhe praktikat e autorizimit në fuqi. Në çdo rast, midis aspekteve për t'u marrë parasysh në zgjedhjen e propozimeve për t'u pranuar, Shoqëria e interesuar e Grupit duhet t'i kushtojë vëmendje çdo konflikti të mundshëm të interesit të një natyre personale dhe të ndërmarrjes.

Sipas kriterëve të arsyeshmërisë dhe proporcionalitetit në lidhje me madhësinë e angazhimit ekonomik të parashikuar për Grupin, gjithashtu duhet të përcaktohen më parë nga funksioni i kompanisë "process owner" natyra dhe rëndësia e nismës, identiteti dhe profili i reputacionit të marrësve të sponsorizimit ose kontributit (promovuesit, organizatorët, etj.), dhe gjithashtu duhet të verifikohen zhvillimi konkret i vetë iniciativës dhe në veçanti

përputhja e saj me programin e propozuar për kompaninë përkatëse të Grupit.

x. Aktiviteti i zhvillimit tregëtar

Aktiviteti i promovimit dhe zhvillimit tregëtar duhet të kryhet në respektim të besimit të mirë në drejtimin e biznesit dhe të konkurrencës së lirë. Grupi Comdata nuk toleron asnjë ndërhyrje në parimet e mësipërme të tillë që të kushtëzojnë edhe nëpërmjet njohjes së parave, të mirave dhe/ose dobive të tjera për palët e treta (publike dhe private), negociatat tregëtare që kanë për qëllim fitimin e klientelës së re ose të porosive dhe kontratave të reja.

xi. Regjistrimet kontabël Çdo operacion ose transaksion i Grupit duhet të rregjistrohet saktë në sistemin e kontabilitetit të ndërmarrjes sipas kriterëve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet kontabël të zbatueshme. Çdo operacion ose transaksion duhet të jetë i autorizuar, i verifikueshëm, i ligjshëm, koherent dhe i përshtatshëm.

Në mënyrë që kontabiliteti t'i përgjigjet kërkesave të vërtetësisë, plotësisë dhe transparencës, për çdo operacion duhet të ruhet në aktet e Grupit një dokumentacion i plotë dhe i përshtatshëm që vërteton aktivitetin e kryer, me qëllim që të mundësojë:

- / regjistrimin e saktë kontabël;
- / përcaktimin e menjëhershëm të karakteristikave dhe arsytimit në bazë të këtij operacioni;
- / rindërtimin e lehtë formal kronologjik të operacionit;
- / verifikimin e procesit të vendimmarrjes, autorizimit dhe realizimit, si dhe identifikimin e nivele të ndryshme të përgjegjësisë.

Për këtë arsye secili punonjës ka detyrimin të bashkëpunojë – për sa i takon – që çdo fakt në lidhje me menaxhimin e e Grupit të jetë i regjistruar saktësisht dhe në kohë në kontabilitet, Çdo regjistrim kontabël duhet të reflektojë saktësisht atë që rezulton nga dokumentacioni mbështetës. Për këtë arsye, do të jetë detyrë e secilit punonjës që të kujdeset që dokumentacioni mbështetës të jetë lehtësisht i gjendshëm dhe i rregullt.

9/

*Trajnimi  
i personelit*



Çdo shoqëri e Grupit nxit njohjen me Politikën, Kodin Etik dhe Normativën Antikorrupsion nga ana e gjithë personelit.

Secila shoqëri e Grupit planifikon dhe drejton aktivitetet e trajnimit në këtë fushë, për të siguruar që punonjësit e saj të kuptojnë në lidhje dhe në respekt të pozicionit që mbulojnë:

- / rreziqet e Korrupsionit ndaj të cilit ata dhe organizata së cilës i përkasin mund të ekspozohen;

- / politikën e parandalimit të Korrupsionit;

- / aspektet , lidhur me rolin e tyre brenda Grupit, e sistemit të menaxhimit për parandalimin e Korrupsionit;

- / veprimet paraprake që duhen ndërmarrë dhe raportimet që duhen bërë në lidhje me rrezikun ose dyshimin për praktika të paligjshme.

Pjesëmarrja në aktivitetet e trajnimit është e detyrueshme. Drejtorja e Burimeve Njerëzore e një shoqërie monitoron që procesi i trajnimit i planifikuar të jetë shfrytëzuar nga i gjithë personeli.

Politika i komunikohet gjithë personelit dhe vihen në dispozicion sipas modaliteteve që janë në fuqi pranë shoqërive të veçanta.



10/

*Raportimi  
i sjelljeve  
jo të  
përshtatshme*



Cilido që vihet në dijeni për një shkelje reale ose të hamendësuar, të Normave Antikorrupsion ose të kësaj Politike, është i detyruar ta raportojë atë menjëherë, duke përdorur një nga kanalet e treguara në vijim:

- a) Drejtoria e Internal Audit e Grupit, e kontaktueshme në adresat e mëposhtme:
  - /// Drejtoria e Internal Audit pranë Comdata S.p.A., via Caboto 1-20094 Corsico (MI), ose
  - /// [internal.audit@comdatagroup.com](mailto:internal.audit@comdatagroup.com)
- b) Funkzioni lokal i ngarkuar për monitorimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm pranë Shoqërisë konkrete të referuar;
- c) platforma digjitale e dedikuar për Bilbilfryrësit (Sinjalizuesit), e arritshme në adresën web <https://whistleblowing.comdatagroup.com>.

Kjo platformë mundëson për gjithsecilin (punonjës e bashkëpunëtor, furnitor e çdo subjekt tjetër që ka pasur ose dëshiron të ketë marrëdhënie biznesi me Shoqërinë) që të raportojë – nëpërmjet një udhëzimi on line – rasti i shkeljes së Politikës Antikorrupsion (përveç sjelljeve të paligjshme ose parregullsive, shkeljet e normave, të Kodit Etik, të procedurave e urdhërave të ndërmarrjes në përgjithësi). Platforma menaxhohet nga një subjekt i specializuar, i tretë dhe punonjës i pavarur në lidhje me Grupin Comdata. Sistemi lejon dërgimin e raportimeve pa detyrimin e regjistrimit dhe deklarimit të gjeneraliteteve. Nëse raportuesi zgjedh të tregojë gjeneralitetet e veta, konfidencialiteti është i garantuar.

Raportimet e dërguara nëpërmjet platformës së mësipërme merren nga Drejtoria e Internal Audit e Grupit Comdata dhe verifikohen e menaxhohen prej saj në përputhje me Policy Ehistlebloëing.

11 /

*Masa  
sankcionuese*



Për secilën Shoqëri të Grupit, Policy hyn në fuqi nga momenti i miratimit zyrtar nga ana e organit administrativ.

Shkelja e Policy nga ana e punonjësve të Grupit përpën një paligjshmëri disiplinore dhe si e tillë, ajo do të jetë objekt i vlerësisht dhe zbatimit të sanksioneve të parashikuara nga Sistemi Disiplinor në fuqi pranë shoqërisë konkrete të referuar, pavarësisht nëse kjo shkelje është rrjedhojë ose jo e një sjelljeje të paligjshme.

Grupi Comdata siguron, gjithashtu bashkëpunimin e saj të plotë për Autoritetet kompetente.

Shkelja nga palët e treta të parimeve dhe parashikimeve të Policy mund të sjellë, në bazë të vlerësimeve specifike të shoqërisë së interesuar të Grupit, moskrijimin ose zgjidhjen e marrëdhënieve kontraktore.

12/

*Monitorimi  
dhe përmirësimi  
i vazhdueshëm*



Drejtoria Internal Audit e Grupit, në bazë të programit aktual të veprimtarisë të miratuar nga Bordi Drejtues i Comdata S.p.A., shqyrton dhe vlerëson sistemin e kontrollit të brendshëm me qëllim verifikimin se parashikimet e Policy zbatohen drejt.

Kur ka shkelje, Drejtoria e Internal Audit e Grupit do të informojë Komitetin e Compliance që do të vlerësojë mundësinë për bërjen e rishikimeve dhe ndryshimeve në Policy dhe/ose në normativën e brendshme me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe pengimin e përsëritjes së shkeljes.

13/

# Flukset e informacionit



Drejtoria Internal Audit e Grupit raporton tek Compliance Committee të Comdata S.p.A. mbi zbatimin e Policy, së paku çdo gjashtë muaj (kur rrethanat nuk kërkojnë një komunikim më të afërt ad hoc), si duke ju referuar veprimtarisë së zhvilluar direkt, ashtu dhe referuar veprimtarisë së funksionarëve lokalë të ngarkuar me monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm pranë shoqërive të kontrolluara.

Drejtoria Internal Audit e Grupit përcjell, gjithashtu, një informacion të posaçëm – brenda relacionit të saj gjashtëmujor – tek Organet e Drejtimit dhe Kontrollit të Comdata S.p.A. për zbatimin e Policy.

Funksionarët lokalë të ngarkuar për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm:

a) I japin Drejtorisë Internal Audit të Grupit – me një frekuencë sistematike – të dhëna për planifikimin, zhvillimin dhe rezultatet e veprimtarisë së auditit të kryer pranë shoqërive përkatëse dhe çdo informacion të nevojshëm ose të dobishëm për dhënien e një informacionit të drejtë mbi gjendjen e zbatimit të Policy pranë vetë shoqërisë së përkatësisë dhe shoqërive të kontrolluara prej saj.

b) Rakordohen në nivel lokal, me funksionarin kompetent ligjor për t'u përditësuar lidhur me zhvillimin normativ dhe juridik në sektorët me interes.





*Leading the way in Customer Interaction  
& Process Management.*